



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC**

Numri i lëndës: 2022:196808

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428925

**PPP. nr. 43/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Dega në Glllogoc/Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KESCO) të cilën e përfaqëson Q.R, kundër debitores S.K nga Komuna Glllogoc, lidhur me borxhin në vlerë prej 2,158.16 Euro, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitorja kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat Rr.M P.nr... të datës 02.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në të cilën ish-in prezent përfaqësuesi i kreditorit dhe debitorja, gjykata me dt.07.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar** prapësimi i debitores S.K nga Komuna Glllogoc, kundër Urdhërit të Përmbaruesit Privat Rr.M P.nr... i datës 02.03.2015, me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KESCO) në shumën prej 2.158,16 Euro, ashtu që **SHFUQIZOHET** Urdhëri përmbarimor i Përmbaruesit Privat P.Nr... i datës 02.03.2015 në shumën e borxhit prej 920,63 Euro për periudhën kohore prej datës 06.05.2013 gjer me datën 19.02.2014, ndërsa urdhëri mbetet në fuqi për shumën e borxhit prej 1.237,53 Euro për periudhën kohore prej datës 20.02.2014 gjer me datën 14.01.2015.
- II.** Në rast të ankesës nga debitori S.K kundër këtij aktvendimi urdhërohet debitori konform Nenit 78 par. 1 të LPP-së që paraprakisht të paguan garancinë në të holla në shumën prej 50% të borgjit kryesor prej 1.237,53 si parakusht për ushtrimin e ankesës, në të kundërtën gjykata konform Nenit 78 par. 4 të LPP-së do të konsideroj se ankesa nuk është dorëzuar.

**A r s y e t i m**

Kreditori Korporata Energjetike e Kosovës ne Prishtinë SH.A (KEK)ka parashtuar propozim te Përmbaruesi Privat Rr.M për lejimin e përmbarimit në bazë të Ekstraktit të verifikuar për

konsumin e energjisë elektrike nga datë 08.05.2013 deri me datën 13.01.2015, si dhe shpenzimet e procedurës.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka lëshuar urdhër P. nr... me datën 02.03.2015 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Ekstraktit të verifikuar.

Këtë çështje përmbartimore gjykata ka vendosur me Aktvendimin PPP.nr.72/17 me dt.15.01.2019 ndaj të cilit kreditori ka bërë ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila gjykatë në bazë të Aktvendimit Ac.nr.1225/19 i dt.17.03.2020 e ka anuluar Aktvendimin PPP.nr.72/17 të dt.15.01.2019 dhe çështjen e ka rikthyer ne rivendosje.

Gjykata, duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, e ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesore me dt.21.02.2024, ku kane prezantuar palët ndërgjyqës. Përfaqësuesja e Kreditores, Debitorja V.K dhe S.K.

Përfaqësuesi i kreditorit ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: propozimi për përmbartim është në përputhje me Nenin 29 dhe 40 të LPK-së përfshirë edhe Nenin 341 të LPK-së ku kreditori nga përmbartuesi privat ka kërkuar përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm ndërsa duke pas sugjerimet e Gjykatës së Apelit ka bërë precizimin në kuptimin subjektiv ku debitorin në këtë çështje duhet të jetë S.K nga komuna e Gillogocit ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkon nga gjykata që prapësimin e debitores të e refuzoj si të pa bazuar në ligj ashtu qe debitorja të obligohet të paguaj borxhin si në propozim për përmbartim.

Gjykata në seancë e ka aprovuar propozimin e kreditorit për precizim subjekt duke vendosur që si debitor në këtë çështje përmbartimore tani e tutje duhet të jetë S.K.

Gjatë seancës, debitorja S.K ka deklaruar se: e konfirmojë deklarin e V.K ku e njëjta ka deklaruar se në pronën në fjalë nuk jeton që 15 vite, ndërsa tutje ka shtuar se faturat e rrymës janë duke ardhur në emër të saj dhe kanë bërë marrëveshje tek noteri ndërsa në pronën ne fjale ka njoftuar se nuk jeton që 5 vite por e njëjta ka jetuar në vitin 2013 deri ne vitin 2015 ndërsa nuk ka jetuar V..., në fjalën përfundimtare ka deklaruar mbetet pranë deklarinëve të dhëna në seancë dhe ka kërkuar që gjykata gjatë vendosjes të këtë parasysht gjendjen e saj ekonomike.

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike përmbartimore ka administruar provat si në vijim: propozimin për përmbartim dhe urdhri përmbartimorë i dt.02.03.2015 me P.nr... të përmbartuesit privat Rr.M, Transaksioni i konsumatorit i dt. 11.02.2015, prapësimi i dt. 19.10.2017, kontrata mbi shfrytëzimin e banesës dt. 06.11.2012 dhe dt. 08.01.2016, të dhënat për konsumatorin e dt. 27.10.2017, transaksionet e konsumatorit dt.12.10.2017, dëftesa e pagesës e dt. 01.07.2021 që konfirmon se ora/njehsori elektrik... është në emër të debitores S.K me nr..., deklarata nën betim e V.D dhe S.K me nr...; Transaksionet e konsumatorëve 05.10.2018, Kontrata për furnizimin me energji elektrike mes S.K dhe kreditorit e dt .05.11.2018.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e provave mbështetur në dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) dhe të dispozitave ligjore të LPP-së dhe të LMD-së të referuara më poshtë, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar pjesërisht, andaj dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Gjykata me leximin e provës materiale-Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës me nr... e dt. 06.11.2012 dhe provës materiale Kontrata 01 Nr... e datës 08.01.2016, gjykata ka vërtetuar faktin

se V.K ka qenë duke jetuar në... Komuna e Glllogocit, ndërsa nuk ka qenë duke jetuar në fsh..., Komuna e Glllogocit.

Me leximin e provës materiale - Deklarata nën betim LPR-nr. rend... e dhënë nga V.K dhe S.K, gjykata ka vërtetuar faktin se debitorja S.K me vullnetin saj të lirë ka pranuar që të regjistroj njehsorin e energjisë elektrike me numër... pasi që në shtëpinë ku është vendosur njehsori elektrik i lartëcekur ka jetuar S.K së bashku me familjen e saj, ndërsa njehsori ka qenë i regjistruar në emër të ish debitores V.K.

Me leximin e provës materiale - Kontrata për furnizimin me energji elektrike e lidhur mes Kreditores dhe debitores S.K, gjykata ka vërtetuar faktin se kreditorja dhe tani debitorja S.K kanë lidhur kontratë mbi furnizimin e shtëpisë me energji elektrike në njehsorin elektrik të lartëcekur.

Me leximin e provës materiale - Transaksioni i konsumatorit i datës 11.02.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se debitori nuk ka bërë pagesa kohë për periudhën kohore prej datës 09.05.2013 gjer 14.01.2015 duke mos i kryer obligimet ndaj kreditorit duke mbetur borxh për energjinë e shpenzuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitores të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitores është i bazuar pjesërisht.

Gjykata, me shikimin e shkresave të lëndës vërtetoi faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të besueshëm-Transaksionet/Ekstraktit të verifikuar të lartëcekur për shkak të detyrimit në të holla si më lartë, i cili propozim është lejuar me urdhërin e Përmbaruesit Privat e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së për realizimin e detyrimit në të holla që rrjedh nga këto ekstrakte si në rastin konkret.

Debitorja në prapësimin e saj ka pretenduar se nuk ka obligim ndaj kreditorit pasi dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, gjykata nuk e aprovoj këtë pretendim të debitores, ndërsa kreditori në anën tjetër propozimit për përmbarim i ka bashkangjitur dokumentet e besueshëm-Transaksionet/Ekstraktet e verifikuara të cilat i plotësojnë kushtet ligjore për të u trajtuar dokument i besueshëm në kuptim të Nenit 29 të LPP.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në Nenin 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së ku përcakton se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: janë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake:.* Në rastin konkret, borxhi nga periudha prej datë për periudhën kohore prej datës 06.05.2013 gjer me datën 19.02.2014 është parashkruar pasi që ka kaluar afati ligjor prej një viti mbi parashkrimin duke u bazuar në Nenin 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së sepse kreditori propozimin për përmbarim e ka paraqitur me datën 27.02.2015 apo 8 ditë më shumë përtej afatit ligjor të parashkrimit prej një vit sipas Nenit 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së, dhe se për këtë periudhë kohore prej datës 06.05.2013 gjer me datën 19.02.2014 debitori nuk ka paguar ndonjë shumë të borxhit për të ndërprerë parashkrimin siç përcaktohet në Nenin 368 të LMD-së që përcakton se *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”*, dhe në Nenin 373 par. 2 i LMD-së përcakton se *“Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi”*.

Lidhur me borxhin për periudhën kohore prej datës 20.02.2014 gjer me datën 14.01.2015 gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, kjo referuar Nenit 360 par. 2 të LMD-së, ku përcaktohet se “*Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë*”.

Lidhur me atë se me çfarë baze juridike caktohet përmbarimi, se çka përmban dokumenti i përmbarimit, se çka duhet të përmbajë një propozim për përmbarim të dokumentit të besueshëm, si dhe kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit në bazë të ekstrakteve janë të përcaktuara me dispozitat ligjore të Nenit, 22, 29, 37, 38 dhe 40 të LPP-së, ndërsa shkaqet e prapësimit janë përcaktuar në Nenin 71 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentet e besueshme nga të cilat shihet se debitori i ka borxhin në fjalë kreditorit.

Andaj, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi urdhërin përmbarues për caktimin e përmbarimit P.nr... i datës 02.03.2015 me ndryshimet si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke u bazuar në Nenin 73 par. 3 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Glllogoc  
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 43/20, datë 07.03.2024**

**G j y q t a r i  
Astrit Gashi**

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditë nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën prej 50% të borxhi kryesor konform Nenit 78 par. 1 të LPP.